



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
OEVERIA - VLADA - GOVERNMENT

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA - POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT - ODELJENJE ZA INSPEKCIJE - DEPARTMENT OF INSPECTION



Referencë: **IPK/08062022/DI**

Datë: **08.06.2022**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit dhe Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024), Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

Titulli - objekti	- Pajisjet policore në funksion të aktiviteteve operative - administrative
Referenca	- 04/2022
Data e inicimit	- 28.02.2022
Data e raportimit	- 08.06.2022
Arsyet e inicimit	- Me propozim të Udhëheqësit të Departamentit të Hetimeve, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Kushtrim Hodaj me datën 28.02.2022 ka kërkuar realizimin e inspektimit të jashtëzakonshëm në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar nivelin e pajisjes së strukturës policore, me pajisje për punë operative, administrative - mbështetëse. Propozimi ka ardhur si rezultat i identifikimit të vështirësive logjistike, në të cilat kanë hasur hetuesit e IPK-së në disa stacione policore.
Objektivi	- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të pajimit të stacioneve me pajisje; - Identifikimi i ciklit jetësor të pajisjeve dhe funksionalitetit të tyre, - Vlerësimi i azhuritit (ekspeditivitetit) të operatorëve të kontraktuar, në përmbushjen e kushteve të kontratave për mirëmbajtje të pajisjeve, - Identifikimi i nevojave lidhur me pajisjet e IT-së dhe pajisjeve policore.
Metodologjia	- Intervista (takime) me 41 zyrtarë të logjistikës dhe bartës funksionesh, - Përdorimi i formularëve verifikues të pajisjeve dhe automjeteve, - Këqyrje dhe verifikim të prezencës dhe gjendjes së pajisjeve, - Marrje dokumentesh për nevoja të raportimit.
Subjekti	- Të gjitha stacionet policore në kuadër të Divizionit për Siguri Publike.
Afatet	- Fillimi - 12.04.2022; - Përfundimi - 15.04.2022; - Periudha e mbulimit - Gjendja momentale.
Kriteret vlerësuese (standardet)	- Ligji nr. 04/L- 076 për Policinë, - Rregullore MF- Nr. 02.2013 për Menaxhimin e Pasurive Jo Financiare në Organizata Buxhetore, - Rregullore për Operativë, - Rregullore për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, - Strategjia e Sigurisë Rrugore dhe Plani i Veprimit në Kosovë.

Ekipi realizues	- Mirsad Puqurica, Udhëheqës i Ekipit të inspektimit, - Fitore Gajraku, inspektor, - Kushtrim Jonuzi, inspektor, - Kadri Keçmezi, inspektor, - Servet Tasholli, inspektor, - Shqiponjë Sopi, inspektor, - Teuta Ajeti - Rukolli, inspektor, - Xhavit Fetahaj, inspektor.
Mbikëqyrur nga	- Ilir Idrizaj, - Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	- Bujar Mustafa, - Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, - Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, - Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së
Datë	- 08.06.2022



<p>Gjetjet kryesore:</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Gjendja teknike e sasiore e automjeteve shpesh ka ngritur shqetësime tek menaxhmenti policor dhe përdoruesit e tyre. Marrë parasysh madhësinë e flotës së automjeteve (1.015)¹ në raport me numrin e personelit (9.005), një (1) automjet është i ndarë mesatarisht për nëntë (9) punonjës. Bazuar në shpërndarjen aktuale, mesatarisht një (1) automjet është i ndarë për 13 punonjës stacionesh². DRP - të në Gjilan, Mitrovicë Veriu dhe Mitrovicë Jugu kanë një gjendje më të rënduar sa i përket ngarkesës me automjete. Nga prizmi i shpërndarjes së tyre, 17 stacione kanë gjendje më të rënduar sa i përket ngarkesës me automjete në raport me numrin e punonjësve (te kjo kategori një automjet është në funksion të 14 - 22 punonjësve). Kurse, 24 stacione tjera policore kanë një gjendje më të mirë, ngase bazuar në ngarkesën që kanë, një (1) automjet i secilit prej tyre është në funksion të 7 - 13 punonjësve. Skenderaj, Mitrovicë Veriu e Deçani kanë një gjendje më të rënduar sasiore, meqë tek secili prej këtyre stacioneve, një automjet policor është i ndarë për 21-22 punonjës <i>(në shtojcë gjeni të bashkëngjitur diagramin nr. 1)</i>. 2. Në periudhën nga 12 -15 prill, nga 317 automjete të stacioneve, 204 prej tyre kanë qenë në funksion (64%), që d.m.th se një e treta e kapaciteteve ka qenë jashtë funksioni, duke ulur kapacitetin aktiv të tyre për aktivitete operative. Rënie më të theksuar të kapacitetit aktiv (funktionalitetit) ka shënuar DRP - Ferizaj (59%), Pejë (58%) e Mitrovicë Veriu (52%). Sipas inspektimit, 23 stacione kanë pasur ulje të kapacitetit aktiv të automjeteve nën mesataren e përgjithshme. Kurse, 18 stacione policore kanë pasur ulje të kapaciteteve, por që nuk kanë zbritur nën mesatare. Stacionet policore në Mitrovicë Veriu dhe në Han të Elezit janë shquar me kapacitete aktive të dobësuara deri në masën prej 33%, përkatësisht 25% <i>(në shtojcë gjeni të bashkëngjitur diagramin nr. 2)</i>. 3. IPK në Raportin e inspektimit nr. 07/2020 ka analizuar vjetërsinë e flotës duke konstatuar se mosha mesatare e automjeteve të Policisë së Kosovës ka qenë rreth 11 vite. Mosha e përgjithshme mesatare për 317 automjetet e shpërndara në 41 stacione policore është rreth tetë (8) vite³. Stacionet e DRP- Mitrovicë Veriu dhe DRP- Mitrovicë Jugu kanë automjete policore ku mosha mesatare e tyre kalon mbi mesataren e përgjithshme (për të parën sillet rreth 13 vite, kurse për të dytën rreth 10 vite). Në 12 stacione (29%), automjetet janë më të vjetra se tetë (8) vite, derisa në 29 të tjera, kanë moshë mesatare rreth tetë (8) vite e më pak. Automjetet policore më të vjetërsuara i kanë stacionet policore në Zubin Potok, Zveçan dhe në Vushtrri, ku mosha mesatare e tyre sillet në 15, 14 dhe 13 vite <i>(në shtojcë gjeni të bashkëngjitur diagramin nr. 3)</i>. 4. Mesatarja e përgjithshme e kilometrave të kaluara për 317 automjete të stacioneve sillet diku 217.640 km. Automjetet e stacioneve në kuadër të DRP-Pejë dhe Gjakovë kanë të kaluar mesatarisht mbi 250.000 km, duke i bërë ato edhe si më të amortizuarat. Sa i përket automjeteve në rrafshin e stacioneve policore, në 14 prej tyre sillet një mesatare prej mbi 250.000
---------------------------------	--

¹ Në këtë shifër janë përfshirë automjetet në qarkullim dhe ato në proces të riparimit, servisimit e mirëmbajtjes. Në këtë numër nuk janë përfshirë autobusët, auto bartjet, automjetet e blinduara, kamionët dhe motoçikletat.

² Sipas raporteve statistikore të drejtorive rajonale për vitin 2021, stacionet policore kanë 3.965 punonjës.

³ Rregullorja MF- Nr. 02.2013 për Menaxhimin e Pasurive Jo Financiare në Organizata Buxhetore në nenin 22 përcakton që të gjitha pasuritë jo financiare kapitale e jokapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit. Kjo Rregullore përcakton se norma e përgjithshme e zhvlerësimit për automjete transporti është shtatë (7) vite.

	<p>km të kaluara, kurse gjendje më e rënduar mbretëron në stacionet policore në Istog, Junik, Kamenicë, Lipjan, Kllokot dhe Graçanicë, ku mesatarja e kilometrave të kaluara për të gjitha automjetet e tyre sillet nga 314.552 - 368.361 <i>(në shtojcë gjeni të bashkëngjitur diagramin nr. 4)</i></p> <p>5. Pajisjet teknike të patrullave janë element me rëndësi meqë ndihmojnë në kryerjen profesionale të detyrave. Në këtë drejtim, matësit e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve (radarët) konsiderohen si mjet pune që ndihmojnë në kontrollin e duhur të trafikut⁴. Përdorimin e radarëve e parasheh edhe Rregullorja për Personel e Administratë, në nenin 193 (Llojet e pajisjeve të domosdoshme). Gjatë viteve të fundit nuk është hasur gjendje e duhur e pajisjes me radarë dhe inspektimi ka ofruar një mundësi për të verifikuar nëse gjërat kanë lëvizur për së mbari. Inspektimi vë në pah se kapacitetet aktive të stacioneve lidhur me radarët janë në masën prej 49%. Stacionet kanë qenë të pajisur me 74 radarë, nga të cilët 38 sosh (51%) kanë qenë jofunksional (të dëmtuar, apo të pa kalibruar). Stacionet janë të ngarkuara mesatarisht me 1.8 radarë, por që në funksion kanë mesatarisht 0.9 radar secila nga to <i>(në shtojcë gjeni të bashkëngjitur diagramin nr. 5)</i>.</p> <p>6. Shtatë (7) stacione policore të DRP - Gjilan kanë në funksion gjithsej tetë (8) radarë, pesë (5) stacione të DRP - Ferizaj (2 sosh), nëntë (9) stacione të DRP- Prishtinë (6 sosh), pesë (5) stacione të DRP- Prizren (9 sosh), tre (3) stacione të DRP- Gjakovë (3 sosh), pesë (5) stacione të DRP - Pejë (5 sosh), tre (3) stacione të DRP - Mitrovicë Jugu (2 sosh) dhe katër (4) stacione të DRP - Mitrovicë Veriu (1 sosh). Nëse i hedhim një vështrim pajimit me radar, secilit stacion veç e veç, del se në ditën e inspektimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 13 nga 41 stacione (32%) nuk kanë pasur në funksion asnjë radar⁵, - 22 nga 41 stacione (53%) kanë pasur në funksion nga një (1) radar, - 4 nga 41 stacione (10%) kanë pasur në funksion nga dy (2) radarë, dhe - 2 nga 41 stacione (5%) kanë pasur në funksion nga tre (3) radarë. <p>7. Pajisje e rëndësishme për punë operative është edhe alkootesti, përmes të cilit zyrtari policor mund të konfirmojë prezencën e alkoolit tek personat e testuar⁶. Përdorimi i alkootestit parashihet me Rregulloren për Personel dhe Administratë. Strategjia e Sigurisë Rrugore dhe Plani i Veprimit (dhe pse tashmë i skaduar) është dokument me rëndësi që ka përcaktuar si një ndër 130 masat e saj, pajisjen e të gjitha automjeteve me pajisje për matje të alkoolit. Kjo pajisje, sikurse edhe radarët nuk ka qenë mjaftueshëm e disponueshme për Policinë, duke ndikuar negativisht edhe në cilësinë e shërbimit. Inspektimi vë në pah se kapacitetet aktive të stacioneve lidhur me alkootestet kanë qenë në masën prej 57%. Stacionet policore kanë qenë të pajisur me 136 alkooteste, prej të cilëve, 58 sosh (43%) kanë qenë jashtë funksioni. Stacionet janë të ngarkuar mesatarisht me 3.3 alkooteste, por që në funksion kanë mesatarisht 1.9 alkooteste secila. <i>(në shtojcë gjeni të bashkëngjitur diagramin nr. 6)</i>.</p>
--	--

⁴ Neni 246, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat në Trafikun Rrugor përcakton që “shpejtësia e lëvizjes së mjetit konstatohet me pajisje të matjes së shpejtësisë së lëvizjes së mjetit, me të dhëna në tahograf, duke përcjellë drejtpërdrejt mjetin me anë të video incizimeve, me pajisje mobile dhe statike apo të ngjashme”.

⁵ Nëse i referohemi shpërndarjes së radarëve funksional sipas stacioneve rezulton se në periudhën e inspektimit, stacionet policore në Kamenicë, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Graçanicë, Lipjan, Prishtinë Jugu, Prishtinë Veriu, Rahovec, Mitrovicë Jugu, Mitrovicë Veriu, Zubin Potok dhe Zveçan nuk kanë pasur asnjë radar në funksion.

⁶ Neni 245, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat në Trafikun Rrugor rregullon që “policia mund t’i detyrojë shoferin dhe pjesëmarrësit e tjerë në trafikun rrugor që t’i nënshtrohen procedurës me qëllim të identifikimit të simptomave që janë pasojë e pranisë së alkoolit, të drogave apo të barnave të cilat ndikojnë në aftësitë psiko-fizike dhe në aftësitë e drejtimit së mjetit”.

	<p>8. Sipas të dhënave të inspektimit, shtatë (7) stacione të DRP - Gjilan kanë në funksion 12 alkooteste, pesë (5) stacione të DRP - Ferizaj (8 sosh), nëntë (9) stacione të DRP - Prishtinë (14 sosh), pesë (5) stacione të DRP-Prizren (11 sosh), tre (3) stacione të DRP - Gjakovë (7 sosh), pesë (5) stacione të DRP - Pejë (10 sosh), tre (3) stacione të DRP - Mitrovicë Jugu (8 sosh) dhe katër (4) stacione të DRP - Mitrovicë Veriu (8 sosh). Nëse i hedhim një vështrim pajimit me alkooteste, secilit stacion veç e veç, del se në ditën e inspektimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 nga 41 stacione (2.4%) nuk ka pasur në funksion asnjë alkootest⁷, - 14 nga 41 stacione (34.2%) kanë pasur në funksion nga një (1) alkootest - 16 nga 41 stacione (39%) kanë pasur në funksion nga dy (2) alkooteste, - 8 nga 41 stacione (19.5%) kanë pasur në funksion nga tre (3) alkooteste, - 2 nga 41 stacione (4.9%) kanë pasur në funksion nga katër (4) alkooteste. <p>9. Nëse i referohemi realizimit të masës që përcakton Strategjia e Sigurisë Rrugore dhe Planit të Veprimit për pajisjen e automjeteve me alkooteste, del se Policia nuk përmbush as për të afërmi kërkesën e tillë. Në raport me numrin e përgjithshëm të automjeteve të stacioneve policore që është gjithsej 317, me alkooteste janë ngarkuar vetëm 136 sish (43%). Por duke pasur parasysh se jo të gjitha alkootestet në kohën e inspektimit kanë qenë funksionale, rezultojnë se në raport me numrin e përgjithshëm prej 317 të automjeteve, 78 e tyre (25%) janë të pajisur me alkooteste funksionale.</p> <p>10. Edhe aparatet fotografike dhe video kamerat janë pajisje të punës shumë me rëndësi për punën policore. Stacionet policore kanë deklaruar gjithsej 175 pajisje të tilla, nga të cilat 103 sosh (72%) janë funksionale. Stacionet policore janë të ngarkuara mesatarisht me 4.2 aparate të tilla, por që në funksion kanë mesatarisht nga 2.5 copë secila. Për këtë pajisje nuk janë paraqitur kërkesa apo shqetësime të shumta, meqë sipas nevojës mund të përdoren edhe telefonat e mençur.</p> <p>11. Në të kaluarën ka pasur pakënaqësi lidhur me pajisjen jo të mjaftueshme me pajisje pune (kompjuter, printer, fotokopje), por edhe mosfunksionim të duhur të shumë prej tyre. Inspektimi i filluar me kërkesë të hetuesve të IPK-së, ka ardhur si rezultat i identifikimit të vështirësive logjistike nëpër disa stacione. Në vazhden e këtij inspektimi, inspektorët kanë verifikuar nivelin e pajimit të stacioneve me pajisje të teknologjisë informative dhe në këtë raport pasqyrohen të dhëna dhe mbi kompjuterët, printerët, si dhe fotokopjet. Stacionet kanë deklaruar që nga 1.409 kompjuterë, 1.260 prej tyre i kanë në funksion. Kapaciteti aktiv i përgjithshëm sillet të jetë 89% (kapaciteti më i ulët është në stacionet policore të DRP- Gjakovë me 69%. Kur shikojmë raportin e numrit të kompjuterëve të ndarë për stacione, me numrin e punonjësve, na pasqyrohet një mesatare e përgjithshme, sipas të cilës një (1) kompjuter është ndarë për tre (3) punonjës (kjo mesatare pothuajse është e njëjtë dhe për raportin ndërmjet numrit të kompjuterëve funksional me numrin e punonjësve). Gjendje më e rënduar qëndron në Stacionin Policor të Gjilanit, ku në një kompjuter duhet qasur numër më i madh punonjësish, për shkak të numrit të kufizuar të kompjuterëve, krahasuar me stacionet tjera. IPK-ja ka marrë shqetësime të shumta mbi mosfunksionimin e duhur të një numri të madh kompjuterësh, si rezultat i vjetërsimit të tyre <i>(në shtojcë gjeni të bashkëngjitur diagramin nr. 7).</i></p>
--	---

⁷ Nëse i referohemi shpërndarjes së alkootesteve funksionale sipas stacioneve policore rezultojnë se në periudhën e inspektimit, Stacioni Policor - Prishtinë Jugu nuk ka pasur asnjë alkootest në funksion.

	<p>12. Stacionet kanë numër të madh të pajisjeve që nuk janë duke i shfrytëzuar, si rezultat i shërbimeve të kontraktuar dhe këtu hyjnë pajisjet, si: printer, printer - fotokopje, si dhe fotokopje. Për momentin stacionet policore janë duke i përdorur 110 printerë nga gjithsej 284 sa i kanë të deklaruar, katër (4) fotokopje-printer nga gjithsej 28 dhe gjashtë (6) fotokopje nga gjithsej 41 të tilla. Për nevoja të këtij inspektimi, IPK-ja në analizat e mëtejme do të marrë parasysh vetëm numrin e atyre pajisjeve policore që janë duke u përdorur. Kapacitetet në përdorim do të mund të jenë jo të qëndrueshme, meqë për shumë prej pajisjeve policore që janë në përdorim, funksionimi i tyre do të varet nga harxhimi i tonerëve, çka më pas edhe mund të dalin jashtë përdorimi. Andaj, këto kapacitete policore të pasqyruara në raport, janë kapacitete momentale (në shtojcë gjeni të bashkëngjitur tabelën 1).</p> <p>13. Stacionet policore kanë deklaruar se kanë në përdorim 110 printerë (pjesa tjetër janë me defekt ose janë tërhequr, për shkak se shërbimet e printimit janë kontraktuar). Kontraktori ka shpërndarë 35 printerë, prej të cilëve 33 kanë qenë duke punuar në periudhën e inspektimit. Policia ka në funksion edhe printerë - fotokopje, të cilat pajisje mundësojnë lidhje më të gjerë të përdoruesve në shërbime printimi. Stacionet janë duke përdorur dhe katër (4) fotokopje-printer (pjesa tjetër janë me defekte ose nuk janë aktive për arsye të cekura). Kontraktori ka shpërndarë 157 fotokopje-printerë nga të cilat, 127 janë hasur në funksion. Në ditën kur është realizuar inspektimi, stacionet kanë deklaruar 306 pajisje në përdorim me operacion printimi⁸, nga të cilat, 32 jo funksionale. IPK ka analizuar shpërndarjen e pajisjeve të printimit në raport me numrin e kompjuterëve në nivel të stacioneve. Përgjithësisht një (1) pajisje printimi ka qenë në dispozicion të katër (4) kompjuterëve. Nga tabela 2 e paraqitur në shtojcë del se raporti ndërmjet numrit të kompjuterëve funksional kundrejt pajisjeve të printimit (printer, printer - fotokopje), duket si vijon: DRP - Gjilan (1:3), DRP-Ferizaj (1:2), DRP-Prishtinë (1:5), DRP-Prizren (1:8), DRP-Gjakovë (1:5), DRP-Pejë (1:5), DRP- Mitrovicë Jug (1:4) dhe DRP- Mitrovicë Veriu (1:3).</p> <p>14. Stacionet kanë deklaruar se janë duke u funksionuar gjashtë (6) fotokopje (pjesa tjetër ose janë defekt ose janë tërhequr nga funksioni). Kontraktori ka shpërndarë nëntë (9) të tjerë, nga të cilët, gjashtë (6) janë hasur duke punuar. Kapacitetet reale të kopjimit dhe ngarkesa për punonjës kuptohet kur analizohet edhe sasia fotokopjeve-printerëve (pasqyruar në tekstin më lartë). Stacionet kanë deklaruar 176 pajisje në përdorim me operacion të kopjimit⁹, ku 33 nga to kanë qenë jofunksional. Kapaciteti i përgjithshëm i kopjimit (ngarkesa për numër punonjësish) është një pajisje (fotokopje, fotokopje-printer) për 23 punonjës. Meqë në ditën e inspektimit, numër i konsideruar i pajisjeve nuk ka punuar (të shumtën e rasteve për mungesë të ngjyrës), ky raport ka ndryshuar (1:28). Kur u referohemi të dhënave përmbledhëse të stacioneve në nivel të drejtorive rajonale, për kapacitetet e përgjithshme të kopjimit, shihet se 33 pajisje kopjimi të kontraktorit nuk kanë punuar për shkaqe defektesh apo për mungesë ngjyre. Sa i përket shpërndarjes së pajisjeve të kopjimit, gjendje më e rënduar pasqyrohet në stacionet policore të katër DRP-ve (Gjilan, Prishtinë, Pejë dhe Mitrovicë Veriu), ku një (1) pajisje kopjimi është ndarë mesatarisht për 25 punonjës. Diku rreth 81% të këtyre pajisjeve janë funksionale dhe raporti ndërmjet</p>
--	---

⁸ Këtu janë përfshirë printerët dhe fotokopje - printerët e përdorshëm që janë pronë policore (110 printerë dhe 4 fotokopje - printer), si dhe ato të kontraktuara nga operatori ekonomik (35 printerë dhe 157 fotokopje - printer).

⁹ Këtu janë përfshirë fotokopjet dhe fotokopje - printerët e përdorshëm që janë pronë policore (6 fotokopje dhe 4 fotokopje - printer), si dhe ato të kontraktuara nga operatori ekonomik (9 fotokopje dhe 157 fotokopje - printer).

	<p>numrit të pajisjeve kundrejt numrit të punonjësve ka ndryshuar në një (1) pajisje kopjimi për 28 punonjës, kurse në kuadër të stacioneve policore të DRP - Gjilan, DRP - Prishtinë e DRP - Mitrovicë Jugu, ky raport ka qenë 1:36, 1:32 dhe 1:31).</p> <p>15. Fokus i IPK-së në këtë inspektim kanë qenë dhe shqetësimet e stacioneve lidhur më gjendjen e pajisjeve dhe funksionalitetin e tyre. Stacionet kanë pasur vazhdimisht kërkesa për furnizime me radarë, fotokopje, printerë, automjete, aparate - kamera digjitale dhe kompjuterë¹⁰. Këto kërkesa, ato i arsyetojnë për faktin se disa nga pajisjet me të cilat janë ngarkuar ato, janë jofunksionale për shkak të vjetërsisë dhe defekteve, dhe për këtë ato janë të riparueshme. Furnizimet me pajisje printimi, kopjimi e skanimi, kohëve të fundit sigurohen nga operatori i kontaktuar ekonomik, i cili është i obliguar që pajisjet e ofruara, të jenë të mjaftueshme dhe t'i mbajë në gjendje funksionale. Shumica e stacioneve kanë vërejtje në drejtim të operatorit mbi cilësinë e shërbimeve. Ankesat e stacioneve adresuar drejt operatorit kanë të bëjnë me atë se shpesh pajisjet janë jofunksionale, si pasojë e mos furnizimit të rregullt me toner dhe mos intervenimit me kohë për defektet. Është siguruar numër i madh i kërkesave të stacioneve për sigurimin e tonerëve (ngjyrave), si dhe sanimin e defekteve në pajisjet e printimit, kopjimit dhe skanimit. Ngecjet në ofrim të shërbimeve cilësore bëjnë që stacionet shpesh të kenë pengesa në kryerjen e detyrave policore.</p>
<p>Vlerësimi i përgjithshëm</p>	<p>Bazuar në gjetjet e inspektimit, IPK-ja vlerëson se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✦ Shpërndarja e tanishme e automjeteve në disa drejtori rajonale (stacione policore) vështirëson kryerjen efikase të detyrave policore, konsiderohet jo e duhur, duke shtruar nevojën për marrjen në konsideratë të numrit të automjeteve në raport me numrin e punonjësve. ✦ Rreth 2/3 e automjeteve janë hasur të jenë aktive, derisa pjesa tjetër jashtë funksioni. Marrë parasysh vjetërsinë e flotës së automjeteve të para disa viteve, në kuadër të stacioneve vërehet tani një ulje e moshës mesatare të automjeteve në rreth tetë (8) vite. Kurse, sa i përket amortizimit si rezultat i kilometrave të kaluar, rezultojnë një mesatare e përgjithshme prej 217.640 kilometrave të kaluara për të gjitha automjetet. ✦ Kuota e kapaciteteve aktive prej 49% të matësve të shpejtësisë së lëvizjes tregon një gjendje të pa pranueshme të nivelit të pajimit të stacioneve me këtë lloj pajisjeje. Është serioze mungesa e këtyre pajisjeve në një numër të madh të stacioneve. ✦ Marrë parasysh masën nga Strategjia e Sigurisë Rrugore për pajisje të të gjitha automjeteve me alkooteste, rezultojnë që stacionet nuk përmbushin synimet nga kjo fushë. Rreth 57% e alkootesteve në kuadër të stacioneve janë gjetur në gjendje funksionale, kurse sa i përket shpërndarjes së tyre, afërsisht çdo i katërti automjet policor në nivel stacionesh është i pajisur me alkootest funksional. ✦ Pajisja e stacioneve me kompjuterë përgjithësisht është i kënaqshëm. Çdo i treti punonjës në kuadër të stacionit policor është pajisur me kompjuter. Por, brengosë fakti se ka vërejtje sa i përket funksionimit të tyre, ngase shumë prej pajisjeve janë të vjetërsuar dhe punojnë ngadalë, ose kanë defekte. Për momentin, vlerësohet se rreth 89% e kapaciteteve ekzistuese në kuadër të stacioneve janë funksionale.

¹⁰ Stacionet policore: Qendër Prishtinë, Podujevë, Skenderaj, Pejë, Prizren Veriu dhe Vushtrri.


	<ul style="list-style-type: none"> ✦ Lidhur me printimin - kopjimin janë duke u përdorur disa nga pajisjet që janë pronë policore dhe në anën tjetër operatori ekonomik ka shpërndarë pajisje tjera shtesë për të mbuluar nevojat policore. Këto kapacitete janë momentale, meqë çdo ditë dalin jashtë funksioni pajisjet policore. Policia nuk kryen furnizime të reja, pasi shërbimet e tilla i kanë kaluar operatorit ekonomik. ✦ Raporti në mes numrit të pajisjeve të printimit me numrin e kompjuterëve (1:4) nuk duket të jetë i pavoritshëm. Po ashtu, i pavoritshëm nuk duket të jetë edhe raporti ndërmjet numrit të pajisjeve të kopjimit me numrin e punonjësve (1:23). Vlerësohet se duhet pasur kujdes operatori ekonomik në mbajtjen e pajisjeve në gjendje funksionale. ✦ Në adresë të operatorit ekonomik që kujdeset për shërbimet e kontraktuar të printimit - kopjimit janë adresuar një varg kritikash dhe ankesash mbi cilësinë e shërbimit. Janë hasur situata kur stacionet kanë pasur vështirësi të shtypin-kopjojnë dokumente a shkresa në mungesë pajisjesh përkatëse.
<p>Rekomandimet</p>	<p>Bazuar në gjetjet, vlerësimin e përgjithshëm të inspektimit dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve policore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. IPK i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që në bashkëpunim me Drejtorin e Departamentit për Shërbime Mbështetëse të rishikojnë shpërndarjen momentale të automjeteve policore në disa prej drejtorive rajonale (stacione), në drejtim të ngritjes së kapaciteteve shtesë. 2. IPK i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbështetëse që së bashku me Drejtorin e Departamentit për Operacione, të shqyrtojnë situatën aktuale sa i përket numrit të pajisjeve (radarë dhe alkootestet) për të shqyrtuar mundësitë për shtimin e kapaciteteve shtesë, në mënyrë që të ofrohen shërbime cilësore në drejtim të ngritjes së sigurisë. 3. IPK i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbështetëse që të rishikohet politika aktuale e shpërndarjes së pajisjeve të printimit e kopjimit, për t'u siguruar se kapacitetet momentale janë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat (kërkesat). 4. IPK i rekomandon menaxherit të mbikëqyrjes së realizimit të kontratës, që operatori, i cili ka të kontraktuar shërbimet e printimit dhe kopjimit, të monitorohet strikt dhe problemet t'i adresojë, në mënyrë që të sanohen vështirësitë, në të cilat po kalojnë stacionet policore.

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore (në origjinal)	Plani i veprimit
1.	IPK i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që në bashkëpunim me Drejtorin e Departamentit për Shërbime Mbështetëse të rishikojnë shpërndarjen momentale të automjeteve policore në disa prej drejtorive rajonale (stacione), në drejtim të ngritjes së kapaciteteve shtesë.	-I-	Policia e Kosovës do të trajtojë rekomandimin e dhënë me prioritet dhe do të angazhohet të formojë një grup punues i cili do të analizojë gjendjen aktuale të shpërndarjes së automjeteve policore dhe i njëjti do të del me një raport lidhur me shpërndarjen e automjeteve neper drejtori rajonale (stacione).	Dhjetor 2022
2.	IPK i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbështetëse që së bashku me Drejtorin e Departamentit për Operacione, të shqyrtojnë situatën aktuale sa i përket numrit të pajisjeve (radarë dhe alkootestet), për të shqyrtuar mundësitë për shtimin e kapaciteteve shtesë, në mënyrë që të ofrohen shërbime cilësore në drejtim të ngritjes së sigurisë.	-I-	Policia e Kosovës është furnizuar me radar shtesë (radarët e dorës-modeli i fundit), po ashtu ka rregulluar bazën ligjore për kalibrimin/verifikimin e radarëve dhe alkootesteve dhe tani kalibrimi/verifikimi bëhet në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës (AMK). Andaj, mbi këtë bazë synojmë përmirësimin e situatës në terren duke i pajisur me pajisje shtesë DRP-të gjithnjë duke u bazuar në analizat dhe kapacitetet logjistike momentale. Policia e Kosovës duke u bazuar në gjendjen aktuale dhe analizën e kapaciteteve ka ndërmarrë veprime e nevojshme për shtimin e kapaciteteve dhe aktualisht jemi në proces të furnizimit (është nënshkruar kontrata) me 5 copë pajisje për dëshmimin e kundërvajtjeve përmes patrullimit në lëvizje - "vetura të mençura", si dhe janë iniciuar dhe zhvilluar të gjitha procedurat për dy projekte tjera për pajisje të trafikut Furnizim me Radar dore, Mobil dhe Pajisje elektronike mobile për kontrollim dhe identifikim të kundërvajtjeve në trafik të cilat për shkak të ankesave nga operatorët ekonomik kanë përfunduar në OSHP. Ndihmë shtesë në ofrimin e sigurisë rrugore do ofrojë edhe projekti për identifikimin dhe dëshmimin e kundërvajtjeve përmes patrullimit në lëvizje - "vetura të mençura" që pritet të fillojë së zbatuari nga korriku i këtij viti.	Dhjetor 2022
3.	IPK i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbështetëse që të rishikohet politika aktuale e shpërndarjes së pajisjeve të printimit e kopjimit, për t'u	-I-	Ne si Polici e Kosovës kemi kërkuar që të shtohet kapaciteti i printerëve në Stacione/Regjione/Pika Kufitare etj., në kuadër të atyre pajisjeve që i kanë t'u shtohet edhe nga një printer rezervë (backup) që mos të mbeten pa ndonjë	31.12.22


	siguruar se kapacitetet momentale janë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat (kërkesat).		zgjdhje alternative. OE ka filluar me shpërndarjen e 78 pajisjeve në gjithë Kosovës dhe në të ardhmen në bashkëpunim me divizionet dhe drejtoritë rajonale do të bëhet një analizë e shpërndarjes së pajisjeve të printimit dhe kopjimit.	
4.	IPK i rekomandon menaxherit të mbikëqyrjes së realizimit të kontratës, që operatori, i cili ka të kontraktuar shërbimet e printimit dhe kopjimit, të monitorohet strikt dhe problemet t'i adresojë, në mënyrë që të sanohen vështirësitë, në të cilat po kalojnë stacionet policore.	-I-	<p>Duke u bazuar ne gjendjen aktuale dhe ankesat nga njësite e ndryshme te PK-se menaxheri i kontratës ka kërkuar ngritjen e kapacitetit te furnizimit me material shpenzues për pajisjet e kontraktuara, ka njoftuar dhe ka dërguar Vërejtje dhe Ankesa te AQP për OE-në për vonesat ne furnizim, po ashtu ka kërkuar qe ti jepet prioritet pikave me te ndjeshme dhe jemi pajtuar qe te ndahen ne dy kategori :</p> <ul style="list-style-type: none"> - High Priority (Prioritet i larte) – Stacionet, Bazat, Pikat Kufitare etj. - Medium Priority (Prioritet i mesëm) – Administrata, Zyrat e ndryshme. <p>Është ngritur kërkesa ne AQP te behet një ndryshim/plotësim i kontratës për kohe te reagimit/intervenimit/riparimit :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Që intervenimi/reagimi/riparimi të jete sa ma i shpejte dhe më së largu brenda 4 orëve të orarit të punës (p.sh. nëse thirrja nga PK-ja behet para orës 12:00, intervenimi duhet te behet brenda të njëjtës ditë) këtu mund të specifikohet që kjo periudhe e intervenimit të vlejë për qytetet kryesore ku gjenden objekte policore (Prishtine, Mitrovice Jug dhe Veri, Pejë, Prizren, Gjakove, Ferizaj, Gjilan), ndërsa për qytetet, respektivisht objektet tjera policore koha e reagimit të jetë maksimumi 24 ora nga pranimi i thirrjes; 2. Në rast se nuk rregullohet aty për aty pajisja (fotokopja/printeri), ose ne rast se është defekt i madh duhet të ndërrohet pjesa ose të zëvendësohet pajisja komplet deri në 3 dite, gjatë kësaj kohe të prishjes së pajisjes zyrtareve te Policisë duhet ti bëhet një zgjedhje alternative në ndonjë printer/fotokopje (backup) që gjendet në atë objekt. <p>Do te vazhdoj monitorimi strikt i OE për shërbimet e ofruara dhe për te gjitha ankesat do te njoftohet dhe do te kërkohet përmirësimi i shërbimeve nga OE dhe do te njoftohet edhe AQP.</p>	31.12.22

Shtojcat

Diagrami nr. 1 - Raporti i numrit të automjeteve të shpërndara në drejtoritë rajonale (stacionet policore) për numrin e punonjësve



Diagrami nr. 2 - Kapacitetet e drejtorive rajonale (stacioneve policore) sa i përket numrit të automjeteve



Diagrami nr. 3 - Moshja mesatare për automjetet e stacioneve policore (sipas drejtorive rajonale)



Diagrami nr. 4 - Mesatarja e kilometrave të kaluara për të gjitha automjetet e stacioneve policore (llogaritja sipas drejtorive rajonale)



Diagrami nr. 5 - Kapacitetet funksionale (radarët aktiv) të stacioneve policore të pasqyruar sipas drejtorive rajonale



Diagrami nr. 6 - Kapacitetet funksionale (alkootestet aktive) të stacioneve policore të pasqyruara sipas drejtorive rajonale



Diagrami nr. 7 - Kapacitet aktive të drejtorive rajonale (stacioneve policore) sa i përket numrit të kompjuterëve




Tabela nr. 1 - Pasqyrë mbi numrin e pajisjeve në përdorim dhe atyre jashtë përdorimi									
Lloji i pajisjes	Pronë policore			Pajisje të kontraktuara			Kapacitetet		
	Gjithsej	Në përdorim	Jashtë përdorimi	Gjithsej	Në përdorim	Jashtë përdorimi	Gjithsej	Në funksion	Jashtë funksioni
Printer	284	110	174	35	33	2	145	143	2
Printer - fotokopje	28	4	24	157	127	30	161	130	31
Fotokopje	41	6	35	9	6	3	15	12	3

Tabela nr. 2 - Pasqyrë përmblendhëse mbi kapacitetet e printimit (printer dhe printer - fotokopje) dhe raporti i pajisjeve të printimit kundrejt numrit të kompjuterëve									
DRP	Stafi	Kompjuter funksional	Pajisje printimi në pronë policore në përdorim	Pajisje printimi me kontratë në përdorim	Pajisje printimi të kontraktuar ar jo funksional	Kapaciteti i përgjithshëm dhe raporti			
						Gjithsej pajisje printimi	Pajisje printimi në funksion	Pajisje printimi jashtë funksioni	Raporti: Pajisje printimi për kompjuter funksional
Gjilan	500	125	14	17	7	38	31	7	1:3
Ferizaj	357	115	26	18	3	47	44	3	1:2
Prishtinë	1189	356	18	44	11	73	62	11	1:5
Prizren	385	165	5	15	2	22	20	2	1:8
Gjakovë	299	104	8	11	3	22	19	3	1:5
Pejë	456	177	19	18	0	37	37	0	1:5
Mitrovicë J	404	116	6	16	6	28	22	6	1:4
Mitrovicë V	375	102	18	21	0	39	39	0	1:3
Gjithsej	3.965	1.260	114	160	32	306	274	32	1:4

Tabela nr. 3 - Pasqyrë përmblendhëse mbi kapacitetet e kopjimit (fotokopje dhe fotokopje - printer) dhe raporti i pajisjeve të kopjimit kundrejt numrit të punonjësve									
DRP	Stafi	Pajisje kopjimi në pronë policore në përdorim	Pajisje kopjimi me kontratë në përdorim	Pajisje kopjimi të kontraktuar ar jo funksional	Kapaciteti i përgjithshëm dhe raporti				
					Gjithsej pajisje kopjimi	Pajisje kopjimi i në funksion	Pajisje kopjimi i jashtë funksioni	Pajisje të ndara kopjimi për punonjës	Pajisje funksionale kopjimi për punonjës
Gjilan	500	1	13	6	20	14	6	1:25	1:36
Ferizaj	357	1	14	4	19	15	4	1:19	1:24
Prishtinë	1189	3	34	11	48	37	11	1:25	1:32
Prizren	385	1	18	3	22	19	3	1:18	1:20
Gjakovë	299	1	11	4	16	12	4	1:19	1:25
Pejë	456	1	17	0	18	18	0	1:25	1:25
Mitrovicë J	404	2	11	5	18	13	5	1:22	1:31
Mitrovicë V	375	0	15	0	15	15	0	1:25	1:25
Gjithsej	3.965	10	133	33	176	143	33	1:23	1:28